

URDHËR
Nr. 316, datë 13.9.2023

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 23/2015, “Për shërbimin e jashtëm”, nenet 22 e vijues, të ligjit nr. 44, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, nenin 19, pika 2, e ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”,

URDHËROJ:

Delegimin e kompetencës së ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, si vijon:

1. Zbatimin e Programit të Transparencës të Rishikuar, sipas modelit të miratuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale, me urdhrin nr. 187, datë 18.12.2020.

2. Zbatimin e Regjistrit të Kërkesave dhe Përgjigjeve të Rishikuar, sipas modelit të miratuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale, me urdhrin nr. 188, datë 18.12.2020.

3. Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nuk mund t'i nëndelegojë këto kompetenca.

4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME
Igli Hasani